



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/04
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5, paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 2 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009, në pajtim me nenin 9 paragrafi 7 të Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MEPTINIS me nr. prot. 1204, datë 28.02.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohen drejtorët e Bordit Mbikëqyrës të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Trepça" Sh.A. që janë emëruar me vendimin nr. 01/39 të 4 prillit 2018 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Për arsytet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Trepça" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

DATË/E:	28.2.2020
PËR/ZA/TO:	Qeverinë e Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Rozeta HAJDARI – Ministre, MEPTINIS
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT:	Memorandum shpjegues për propozim-vendimin për shkakimin e Bordit Mbikëqyrës të ndërmarrjes publike qendrore “Trepça” Sh.A.

I nderuar Kryeministër Kurti,
të nderuar zëvendëskryeministra Hoti dhe Abazi,
të nderuar ministra:

Si ministre përgjegjëse, **i propozoj Qeverisë të shkarkojë drejtorët që përfaqësojnë Qeverinë në Bordin Mbikëqyrës të ndërmarrjes “Trepça” Sh.A.** Këtë propozim e jap duke u mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës,¹ në Ligjin për ndërmarrjet publike,² si dhe Ligjin për Trepçën.³

Republika e Kosovës është pronare e 80 për qind të aksioneve të Trepçës.⁴ Qeveria, si ushtruese e detyrave të aksionarit, emëron 6 nga 9 drejtorët në Bordin Mbikëqyrës, që është organi analog me bordin e drejtorëve në të tjera ndërmarrje publike ose shoqëri aksionare.⁵ Qeveria mund t’i shkarkojë ata drejtorë sipas Ligjit për ndërmarrjet publike.⁶ Sipas këtij ligji, Qeveria duhet t’i shkarkojë drejtorët kur ka “arsye për të besuar” se kanë shkelur detyrat fiduciare.⁷ Termi *detyrë fiduciare* përkufizohet si detyra për të vepruar me ndershmërinë e besnikërinë më të lartë ndaj ndërmarrjes dhe në interesin më të mirë të saj.⁸

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 119.9.

2 Ligji 03/L-087 për ndërmarrjet publike, ndrysh. me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009 (LNP), neni 5.1.

3 Ligji 05/L-120 për Trepçën (LT).

4 LT, neni 4.

5 LT, neni 9.

6 LT, neni 9.7.

7 LNP, neni 19.3.

8 Termi është huazuar nga anglishtja. Shih zërin *fiduciary duty* në fjalorin juridik *Black’s Law Dictionary*, 9th ed., f. 581.

Në rastin e Trepçës, tërësia e rrethanave rreth menaxhimit të paluajtshmërive dhe punësimit jep arsye për të besuar se Bordi Mbikëqyrës ka lejuar veprime që bien ndesh me interesin e ndërmarrjes.

Gjatë shkurtit 2020, Trepça ka hapur procedura tenderimi për dhënien me qira të pronave të paluajtshme të ndërmarrjes, që përfshijnë disa tokë dhe objekte industriale.⁹ Qiradhënia afatgjate e kësaj natyre bie ndesh me nenin 1 të Ligjit për Trepçën, që “synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes hapjes së rrugës për investime, rritjen e vlerës së aseteve dhe avancimin e kapitalit tekniko teknologjik si parakusht për rivitalizimin e Trepçës si një ndërmarrje me rëndësi të veçantë, jetike për mirëqenien sociale të punëtorëve dhe interesin e përgjithshëm publik.”

Ndërkaq, më 24 shtator 2019, një ditë para fushatës zgjedhore në vend, Trepça ka shpallur konkurs për 220 punëtorë të rinj. Shpallja e kandidatëve të suksesshëm ka ngritur dyshime për keqpërdorime, meqë në krye të listës përfundimtare është vënë një kandidat që nuk ka kaluar testin me shkrim. Gjatë javëve të fundit, banorët e viseve ku operon ndërmarrja kanë protestuar pikërisht kundër procedurave të punësimit. Është njoftuar gjithashtu se Prokuroria Themelore e Mitrovicës ka nisur hetime për shkelje të mundshme penale lidhur me konkursin.

Veprimet dhe mosveprimet e Bordit Mbikëqyrës kanë cenuar interesin e ndërmarrjes, duke dëmtuar imazhin e saj, duke mundësuar ndërhyrjet e tërthorta në fushatën zgjedhore, duke rrezikuar rendin publik dhe duke vënë në pikëpyetje të ardhmen e Trepçës si pasuri strategjike kombëtare.

Mbështetur në literaturën ndërkombëtare, rikujtojmë se profesionalizmi dhe pavarësia politike e organeve drejtuese të ndërmarrjeve publike është e domosdoshme për të luftuar korrupsionin dhe për të penguar kapjen e shtetit.¹⁰

Për arsyet e sipërcekura, i propozoj Qeverisë të shkarkojë 6 drejtorët e emëruar me vendimin e Qeverisë nr. 01/39 më 4 prill 2018.

Rozeta HAJDARI

Ministre

9 Shih, p.sh., shpalljet në sajtin e prokurimit elektronik të Republikës së Kosovës, me numrat 2020/12997 12998-20-204-2-6-10/E02-0001009; 2020/12997 12998-20-204-2-6-10/E07-0001551; 2020/12997 12998-20-204-2-6-10/E07-0001541, etj.

10 Banka Botërore, *Anticorruption Transition: A Contribution to the Policy Debate* (World Bank: Washington, D.C., 2000) f. 9.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/05
Datë: 06.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 43 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009, në pajtim me nenin 9 të Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 mars, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Bordi i Përkohshëm Mbikëqyrës i ndërmarrjes publike qendrore "Trepça" Sh. A. me këtë përbërje:
 - 1.1. z. Sylejman Hyseni, kryesues dhe drejtor, përfaqësues i Republikës;
 - 1.2. z. Bahri Hyseni, drejtor, përfaqësues i Republikës;
 - 1.3. z. Shyqyri Kelmendi, drejtor, përfaqësues i Republikës;
 - 1.4. z. Shyqyri Sadiku, drejtor, përfaqësues i punëtorëve.
2. Mandati i Bordit të Përkohshëm Mbikëqyrës mbaron:
 - 2.1. Ditën që emërohet Bordi Mbikëqyrës me mandat të plotë; ose
 - 2.2. Ditën që bëhen gjashtë muaj nga emërimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Për arsyet e cekura në memorandumimin shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Trepça" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

DATË/E:	06.03.2020
PËR/ZA/TO:	Qeverinë e Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Rozeta HAJDARI – Ministre, MEPTINIS
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT:	Memorandum shpjegues për propozim-vendimin për emërimin e bordit të përkohshëm mbikëqyrës të ndërmarrjes publike qendrore “Trepça” Sh.A.

I nderuar Kryeministër Kurti,
të nderuar zëvendëskryeministra Hoti dhe Abazi,
të nderuar ministra:

Si ministre përgjegjëse, i propozoj Qeverisë ta emërojë një bord të përkohshëm mbikëqyrës të ndërmarrjes “Trepça” Sh.A. Këtë propozim e jap duke u mbështetur në Kushtetutë, në Ligjin për Trepçën dhe në Ligjin për ndërmarrjet publike.¹

Për emërim propozohet kjo përbërje e bordit të përkohshëm mbikëqyrës:

- z. Sylejman Hyseni, kryesues dhe drejtor, përfaqësues i Republikës;
- z. Nazmi Mikullovc, drejtor, përfaqësues i Republikës;
- z. Shyqyri Kelmendi, drejtor, përfaqësues i Republikës; dhe
- z. Shyqyri Sadiku, drejtor, përfaqësues i punëtorëve.

Ligji për Trepçën përcakton se bordi mbikëqyrës emërohet sipas rregullave të Ligjit për ndërmarrjet publike.² Në këtë rast, bordi mbikëqyrës i ndërmarrjes “Trepça” Sh.A. është organ analog me bordin e drejtorëve të paraparë në Ligjin për ndërmarrjet publike.³ Kur shkarkohet bordi, Ligjit për ndërmarrjet publike detyron Qeverinë që sa më shpejt të emërojë një bord të përkohshëm.⁴ Ligji për Trepçën nuk ka rregulla për bordin e përkohshëm, andaj vlejné rregullat e Ligjit për ndërmarrjet publike.

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 119.9; Ligji 05/L-120 për Trepçën (LT); Ligji 03/L-087 për ndërmarrjet publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009 (LNP), nenet 5.1 dhe 43.

2 LT, neni 9.

3 Shih LNP, neni 15.

4 LNP, neni 43.

Në këso rastesh, aksionari emëron katër drejtorë të përkohshëm; kryeshefi i ndërmarrjes shërben si drejtori i pestë në bord. Ndonëse nuk lypset konkurs, për aq sa është e mundshme, duhet emëruar kandidatë që plotësojnë kushtet dhe cilësimet e përcaktuara për drejtorët me mandat të plotë.⁵ Në rastin e ndërmarrjes “Trepça” Sh.A., duhet ndjekur, për sa është e mundshme, edhe kushtet e cilësimet e caktuara në Ligjin për Trepçën.⁶

Tutje, sipas nenit 9 paragrafit 1 të Ligjit për Trepçën, aksionarët përfaqësohen në bord në përpjesëtim me pjesëmarrjen në kapital. Republika e Kosovës ka 80 për qind të aksioneve, kurse punëtorët kanë 20 për qind.⁷ Rrjedhimisht, tre nga katër drejtorët e përkohshëm të emëruar me këtë vendim përfaqësojnë Republikën e Kosovës si aksionare, kurse një drejtor përfaqëson punëtorët.

Tre përfaqësuesit e Republikës janë propozime të Ministrisë që drejtoj. Përfaqësuesi i punëtorëve, z. Shyqyri Sadiku, tashmë ka qenë i emëruar me vendimin e Qeverisë.⁸

Drejtorët e përkohshëm të propozuar nga Ministria janë ekspertë të sektorit në të cilin vepron ndërmarrja dhe ekspertë të qeverisjes së ndërmarrjeve, me përvojë të dëshmuar.

Rozeta HAJDARI

Ministre

5 Shih LNP, neni 17, paragrafët 1 e 4.

6 Shih LT, neni 9.

7 LT, neni 4.

8 Vendim nr. 01/39, 4.4.2018.